



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 17 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, që përbëhet prej katër (4) njësive gjeneruese; HC Shtërpce me kapacitet prej 2.47 MW, HC “Bitinja” 2.1 MW, HC “Vica” 2.5 MW dhe HC “Brod” me kapacitet prej 2.5 MW, në total prej 9.57 MW, në komunën e Shtërpcës, të datës 29.03.2013 të ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k., me adresë “Veternik”, KK Prishtinë, Republika e Kosovës,
- Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, të datës 28 qershor 2013, lëshuar nga ZRRE
- Kërkesën për dhënien e autorizimit preliminar për ndërtim të HC “Brod”, të datës 17.09.2013, të ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k,
- Vendimi i Komunës së Shtërpcës nr. 02-16-2226, i datës 02.08.2013,
- Rekomandimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me nr. 3182/13 të datës 29.08.2013

**në seancën e mbajtur me datë 24 tetor 2013 nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. REFUZOHET dhënia e autorizimit preliminar** për ndërmarrjen “Matkos Group” sh.p.k, për ndërtimin e hidrocentralit “HC Brod” me kapacitet të instaluar prej 2.5 MW, në lumin Lepenc, Komuna e Shtërpcës, Republika e Kosovës.

## **A r s y e t i m**

- ZRRE, me datë 29.03.2013 nga ndërmarrja “**Matkos Group**” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji në Lumin Lepenc, që përbëhet prej katër (4) njësive gjeneruese; “HC Shtërpce” 2.47 MW, “HC Bitinja” 2.1 MW, “HC Vica” 2.5 MW dhe “HC Brod” me kapacitet prej 2.5 MW, në komunën e Shtërpcës.
- Me datë 28.06.2013 ZRRE i ka lëshuar Autorizimin Preliminar ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k., për vetëm tri (3) njësitë: “HC Shtërpce” me kapacitet prej 2.47 MW, “HC Bitinja” 2.1 MW dhe “HC Vica” 2.5 MW, ndërsa, me kërkesë të “Matkos Group” sh.p.k., nuk ka vendosur për njësinë “HC Brod” pasi që për në të njëjtin lokacion ka aplikuar edhe një ndërmarrje (“Hydroenergja” sh.p.k).
- ZRRE me datë 17.09.2013 ka pranuar Kërkesën për dhënien e Autorizimit Preliminar për ndërtim të HC “Brod”, të ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k, me arsyetim se Komuna e Shtërpcës, me Vendim nr. 02-16-2226 të datës 02.08.2013 ka refuzuar kërkesën e



“Hydroenergija” sh.p.k, dhe se Kuvendi i Komunës së Shtërpçës, me datë 31.05.2013 i ka dhënë në shfrytëzim pronën komunale ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k.

- ZRRE, në rrugë zyrtare, ka pranuar nga MMPH Rekomandimin me nr. 3182/13, të datës 06.09.2013 me të cilin MMPH ka kundërshtuar Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtërpçës të cekur më lartë, duke sqaruar se për lokacionin në fjalë ndërmarrja “Hydroenergija” sh.p.k posedon Lejen Ujore me nr. 3684/12-ZSP-70/13 të datës 17.01.2013. Gjithashtu në shkresën/rekomandimin e MMPH ritheksohet se Resurset Ujore në kuadër të së cilave përfshihet edhe toka Ujore, janë kompetencë administrativo-ligjore e MMPH e dhënë me Ligjin për Ujërat e Kosovës Nr. 2004/24, dhe jo kompetencë e Komunave.
- ZRRE, pas vlerësimit të shkresave dhe dëshmive të bashkangjitura aplikacionit si dhe shkresave të cekura më lartë, e posaçërisht vlerësimit të shkresës-Rekomandimit të MMPH si dokument crucial në këtë çështje, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bashkangjitur këtij Vendimi:**

- Rekomandimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me nr. 3182/13 të datës 29.08.2013.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtar

---

Krenar Bujupi, anëtar